

Koncepti i higjienës për Xhamitë gjatë pandemisë së Covid-19



Në përputhje me kërkesat aktuale të raportimit për takime (nga 25.01.2021) me më shumë se 10 persona, duhet t'u komunikohen autoriteteve shtetërore vetëm një herë. Ky lajmërim mjafton për herët e tjera pavarësisht numrit të pjesëmarrësve që mund të frekuentojnë xhaminë.



Ambientet ku do kryhet namazi duhet të jenë të ajrosura mirë para dhe pas çdo namazi. Gjatë namazeve, duhet pasur kujdes që të mos ketë korrent.



Për shkak të rritjes së vazhdueshme të rrezikut të infektimit, numri i vizitorëve duhet kufizuar nga distancat minimale që duhet të mbahen gjatë kryerjes së namazeve. Kjo masë do të thotë që numri i zonave të përdorura në mënyrë aktive për namaz për person është zvogëluar ndjeshëm. Ndarja e vendit për namaz sipas intervaleve të specifikuara duhet të bazohet si më poshtë: - Duhet të ketë një distancë prej të paktën 1,5 m në të djathtë dhe të majtë të një personi dhe një distancë prej 2 m në pjesën e përparme dhe të pasme të personit tjetër që falet. Në provincat me një numër maksimal të vizitorëve, kjo duhet të respektohet.



Për gjurmimin e mundshëm të infeksionit, çdo ditë duhet të mbahet një listë e frekuentimit, në të cilën të gjithë vizitorët të vendosin emrin, mbiemrin dhe numrin e tyre të telefonit. Këto lista duhet mbahen për një muaj në përputhje me udhëzimet për mbrojtjen e të dhënave dhe më pas duhet të fshihen. Duhet të theksohet se nuk lejohet grumbullimi para xhamisë gjatë hyrjen apo daljes prej saj. Xhamitë që presin një numër më të madh të vizitorëve duhet të instalojnë një sistem regjistrimi.



Vetëm personat nga moshë 12 vjeç e lart lejohen të marrin pjesë në kryerjen e namazit në xhami. Ne inkurajojmë njerëzit e moshës 65 vjeç e lart të falen në shtëpi. Vizitorët duhet rregullisht të rikujtohen për këto gjëra nga hoxha.



Personat me simptoma të sëmundjes duhet të mos frekuentojnë xhaminë. Madje edhe nëse testi për covid 19 ka dalë negativ.



Vizitorët e xhamive duhet të informohen paraprakisht ose kur të regjistrohen se mbajtja e maskës mjekësore (OP-Masken, FFP2 ose KN95) është e detyrueshme në xhami. Maska mjekësore duhet të sigurohet nga vetë vizitorët e xhamisë.

Askush nuk lejohet të hyjë në xhami pa maskën mjekësore.



Vizitorët duhet të informohen paraprakisht ose kur të regjistrohen se të gjithë duhet të sjellin me vete sexhaden personale për namaz. Pa sexhade personale, nuk ju lejohe të faleni në xhami.



Vizitorët duhet të udhëzohen paraprakisht për marrjen e abdesit në shtëpi.



Dezinfektuesi i mjaftueshëm i duarve duhet të jetë i disponueshëm në vendet e hyrjes gjatë gjithë kohës. Për më tepër, duhet të përdoret dezinfektues i mjaftueshëm sipërfaqësor për pastrimin e përditshëm të zonave të ndjeshme.



Duhet të shmangen recitimet e përbashkëta si Ilahitë apo Salavatet etj. në mënyrë që të minimizohet mundësia e infektimit përmes pështymës. Vizitorët duhet të informohen paraprakisht, ose nga Imami para faljes së namazit.



Ceremonitë fetare private ose publike të tilla si dasmat apo pamjet mortore nuk janë të lejuara. Ceremonitë në raste të tilla mund të kryhen vetëm në grup më të vogël në përputhje me rregulloret aktuale të provincave përkatëse.



Namazi i xhenazes si një akt tjetër adhurimi është i mundur vetëm në qarqet e ngushta familjare me Imamin. Normalisht duhet të respektohet numri maksimal i përcaktuar nga provincat përkatëse.



Anëtarët e xhamive duhet të informohen për të gjitha masat e parapara. Ata duhet të jenë të informuar paraprakisht rreth rregullave që duhet të zbatohen me qëllim që të përgatiten për të vizituar xhaminë.



Ligjet, dekretet dhe urdhëresat e qeverisë, provincave apo bashkive duhet të respektohen gjithmonë.